

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



LLOGARIA RRJEDHËSE



PËRMBAJTJA

01

Çka është llogaria rrjedhëse?

02

Si hapet një llogari?

03

Për çka na nevojitet llogaria bankare?

04

Kush ka të drejtë të hapë llogari rrjedhëse në banka?

Si të informohemi për çmimet dhe tarifatat për hapjen e llogarisë?

05

Llogaria studentore- Ku mund të hapin llogari studentët?

06

Si mbyllet një llogari rrjedhëse?

07

A duhet të jetë prezent vetë klienti në bankë për ta mbyllur llogarinë?


A ka tarifë për mbylljen e llogarisë?

Çka ndodh nëse nuk e përdor më një llogari por nuk e ke mbyllur?

08

Këshilla të sigurisë

ÇKA ËSHTE LLOGARIA RRJEDHËSE?



Llogaria rrjedhëse është llogari bazike e cila mund të përdoret nga individë dhe biznese për të krijuar marrëdhënie bankare, për të kryer pagesa të ndryshme dhe për të pasur qasje në produkte dhe shërbime bankare.

Llogaria rrjedhëse zakonisht përdoret për të:

- pranuar pagën,
- tërhequr para,
- deponuar para,
- kryer të gjitha llojet e transaksioneve bankare,
- paguar faturat komunale,
- kryer pagesën e kredisë, si dhe
- për të shfrytëzuar shërbime të tjera përmes kartelave të bankës, e-Banking e mobile Banking.

SI HAPET NJË LLOGARI

Këshillë: Para se të aplikoni për hapje të llogarisë, vizitoni web faqet zyrtare të bankave për më shumë informata mbi çmimoret/ listat e tarifave dhe shërbimeve.

Krahasoni kriteret, çmimet, tarifat dhe ofertat, në mënyrë që të bëni zgjedhjen më të përshtatshme për juve.

Para se të hapni llogarinë rekomandohet që të dini se për çfarë arsye/qëllimi po ju nevojitet llogaria.

Në Kosovë, operojnë 12 banka komerciale ([Lista-e-institucioneve-financiare-20.10.2022.pdf \(bqk-kos.org\)](#)), të cilat ofrojnë produkte dhe shërbime të ndryshme.

Llogarinë tuaj mund ta hapni si individ apo si biznes në bankat komerciale në Kosovë, apo në degët e tyre, nëpër të gjitha komunat e Kosovës.



Fillimisht plotësoni një formular apo kërkesë për hapje të llogarisë.

Varësisht nga banka në të cilën aplikoni, nevojiten disa dokumente por më kryesoret janë:

- Një dokument identifikues (letërnjoftim apo pasaportë);
- Faturë komunale jo më e vjetër se 3 muaj;
- Një dëshmi mbi adresën /vendbanimin (p.sh. certifikata e vendbanimit, faturë komunale me adresë, etj.);
- Nëse kërkesa juaj aprovohet nga banka, atëherë ju do të nënshkruani një kontratë e cila përmban kushtet për përdorimin e llogarisë tuaj.

Është shumë me rëndësi të lexoni dhe kuptoni qartë të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja kundrejt asaj kontrate.

PËR ÇKA NA NEVOJITET LLOGARIA BANKARE?

Llogaria bankare na shërben për qasje të lehtë në financat tona dhe për t'i menaxhuar ato në mënyrë të pavarur, të sigurt dhe shumë arsye të tjera siç janë:



01.

Për ruajtjen e parave (si një vend të sigurt për të mbajtur paratë tuaja) në Euro apo valutë tjetër sipas preferencës tuaj.

02.

Për të pranuar para, p.sh pagën mujore, qiranë mujore, etj.

03.

Për t'u informuar për gjendjen e llogarisë, qasje në paratë tuaja 24/7, sa para keni në dispozicion, sa i keni shpenzimet, kursimet, etj.

04.

Për të tërhequr para të gatshme, sipas nevojës, në objektet e bankës apo nga bankomatët (ATM).

05.

Për të deponuar para në bankë, qoftë depozita të afatizuara apo të paafatizuara.

06.

Për të kryer pagesa/transaksione bankare për produkte dhe shërbime të cilat keni nevojë, p.sh pagesat për studime, për faturat mujore, si: rrymë, ujë, ngrohje, etj, për të pranuar e dërguar transfere brenda dhe jashtë vendit.

***Pagesat mund t'i kryeni duke vizituar bankën apo përmes kartelave tuaja nëpërmjet terminaleve POS, përmes e-banking, mobile banking, etj.**

KUSH KA TË DREJTË TË HAPË LLOGARI RRJEDHËSE NË BANKA?

Të drejtë për të hapur llogari rrjedhëse kanë të gjithë qytetarët të cilët kanë mbushur 18 vjet. Ndërsa fëmijët dhe të rinjtë deri në 18 vjet kanë mundësi të hapin një llogari kursimi, (si formë depozite), të cilat mund t'i përdorin kur të mbushin moshën 18 vjeçare.



SI TË INFORMOHEMI PËR ÇMIMET DHE TARIFAT PËR HAPJEN E LLOGARISË?

Bazuar në aktet ligjore dhe rregullativën e BQK-së, respektivisht "Rregulloren për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje të Bankave.pdf (bqk-kos.org). Të gjitha bankat duhet të sigurohen që çdo degë dhe njësi e tyre që merret me shërbimin e klientëve të mbajë në çdo kohë listat e tilla të çmimeve të printuara, të cilat përmbajnë informacionin e nevojshëm të gatshëm për klientin. Informacioni i tillë duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe duhet të jetë i publikuar edhe në faqen zyrtare të bankës.

LLOGARI STUDENTORE- KU MUND TË HAPIN LLOGARI STUDENTËT?

Bankat të cilat operojnë në Kosovë, në mesin e shumë produkteve dhe shërbimeve financiare kanë edhe llogari të veçantë për Studentë.

Dokumentet e nevojshme për hapjen e një llogarie studentore janë:

- Dokument personal të identifikimit;
- Kartela identifikuese e studentit/ indeksi;
- Adresa postare e studentit.

Disa banka ofrojnë llogari studentore falas.

Rekomandim: Para se të hapni llogarinë tuaj studentore, vizitoni çmimoret e bankave (të publikuara në web faqet e tyre) për të parë ofertat e tyre dhe për të bërë krahasime. Kështu do të mund të zhgjedhni ofertën me kushte dhe tarifa më të përshtatshme.

Lexoni me kujdes para se të nënshkruani kontratën që bëni me bankën për të kuptuar saktë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë tuaja.



SI MBYLLET NJË LLOGARI RRJEDHËSE?

Qytetarët mund të mbyllin llogarinë ose ta përfundojnë një shërbim në çdo kohë, për çdo arsye, duke e informuar paraprakisht bankën me shkrim për detajet (përveç në raste të caktuara kur ka kushte specifike të llogarisë që e pengojnë, nuk e lejojnë këtë) dhe duke u siguruar që të gjitha detyrimet (borxhin) tuaja kundrejt bankës janë mbyllur (paguar). Qytetari duhet të bëjë kërkesën për mbylljen e llogarisë (në konsultim me bankën).

*** Sigurohuni që ta merrni konfirmimin nga banka juaj për mbylljen e llogarisë tuaj.**



A DUHET TË JETË PREZENT VETË KLIENTI NË BANKË PËR TA MBYLLUR LLOGARINË?

Po. Për mbylljen e llogarisë kërkohet prezenca fizike e mbajtësit të llogarisë ose të autorizuarit të tij/saj për këtë qëllim, megjithatë sigurohuni që kur e hapni llogarinë, të lexoni të gjitha nenet e kontratës me Bankën, përfshirë edhe kriteret e mbylljes së llogarisë sepse nuk aplikohen kriteret e njëjta nga secila bankë, si dhe që të jeni i qartë me detyrimet e përgjegjësitë që merrni përsipër.

A KA TARIFË PËR MBYLLJEN E LLOGARISË?

Çështja e tarifës për mbylljen e llogarisë trajtohet në mënyrë të ndryshme nga secila bankë dhe kanë kushte e kriteret të ndryshme, varësisht se në cilën bankë e keni llogarinë.

ÇKA NDODH NËSE NUK E PËRDOR MË NJË LLOGARI POR NUK E KE MBYLLUR?

Nëse klienti nuk e ka përdorur llogarinë (brenda afatit kohor të caktuar nga banka), llogaria kalon në llogari pasive e cila nuk mund të riaktivizohet pa prezencë të klientit. Gjithashtu duhet të jeni të kujdesshëm sepse njëkohësisht mund të ngarkoheni me tarifat e mirëmbajtjes së llogarisë, qoftë edhe nëse ju nuk e keni shfrytëzuar llogarinë.



KËSHILLA TË SIGURISË:

- **Bëni kujdes për sigurinë e llogarisë tuaj.**
- **Konrollojeni rregullisht gjendjen e llogarisë tuaj dhe shikoni se sa para keni në llogarinë tuaj.**
- **Shmangeni qasjen në llogari përmes rrjeteve të internetit që duken të pasigurta!**
- **Mbani PIN-ët dhe kodet tuaja të sigurta dhe shmangeni ndarjen e tyre me të tjerët!**
- **Nëse e humbni ose ju vidhet telefoni mobil, të cilin e përdorni për mobile banking ose një shërbim bankar për biseda, informoni menjëherë bankën tuaj!**
- **Kur hyni në ndonjë faqe të internetit, mos e lini kompjuterin tuaj pa mbikëqyrje derisa ta përfundoni!**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



**BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO**

Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,

Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763